



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 778, Datë 04.03.2021

**“Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|      |                 |            |
|------|-----------------|------------|
| Znj. | Juliana LATIFI  | Kryetar    |
| Znj. | Leida MATJA     | Zv/Kryetar |
| Z.   | Eduard YPI      | Anëtar     |
| Znj. | Adriana BERBERI | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d) dhe dh), neni 26 dhe neni 84, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, e ndryshuar si dhe Udhëzimi “Mbi formën e Njoftimit të Përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të:

-Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës ,

**VËREN SE:**

1. Autoriteti i Konkurrencës, është përballur me një numër në rritje të procedurave të kontrollit të përqendrimeve dhe njoftimeve përkatëse lidhur me përqendrimet.
2. Transaksionet e njoftuara ndodhin në tregun e brendshëm shqiptar, por edhe në tregun e huaj ndërkombëtar duke patur impakt në tregun e brendshëm.
3. Transaksionet e njoftuara janë të ndryshme dhe prekin një numër të konsiderueshëm tregjesh dhe sektorësh të ekonomisë.

4. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson transaksionet e njoftuara në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
5. Autoriteti i Konkurrencës, autorizon transaksionet e njoftuara që përbëjnë një përqendrim sipas kuptimit të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në rastet e bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve, të përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kur krijohet një ndërmarrje e përbashkët etj.
6. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson edhe transaksionet të cilat shoqërohen me bashkime të ndërmarrjeve, përfutim kontrolli etj, por që nuk përmbushin kriteret e neneve 10 ose 12 të ligjit nr.9121/2003 “për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d) dhe dh), neni 24 dhe neni 84 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, e ndryshuar si dhe Udhëzimit “Mbi formën e Njoftimit të Përqendrimit”:

### **VENDOSI:**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës” si më poshtë:

Neni 4 “Caktimi i tarifave për ndjekjen e procedurave në rastet e kontrollit të përqendrimeve” pika 1 e Rregullores, ndryshohet si më poshtë:

1. *Për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës, në rastet e kontrollit të përqendrimit, aplikohen tarifat e mëposhtme:*
  - a. *Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrjet pjesëmarrëse i një transaksioni, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 10 ose 12 të ligjit dhe për të cilin nuk kërkohet plotësimi i “Formularit të Njoftimit të Përqendrimit”, bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.*
  - b. *Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës i “Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit” nga ndërmarrjet pjesëmarrëse, sipas përcaktimit të nenit 10 dhe 12 të ligjit (që bashkohen, që përftojnë kontroll, për krijimin e një ndërmarrjeve të përbashkët si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.*
  - c. *Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës i “Formularit të Plotë të Njoftimit të Përqendrimit” nga ndërmarrjet pjesëmarrëse, sipas përcaktimit të nenit 10 dhe 12 të ligjit (që bashkohen, që përftojnë kontroll, për krijimin e një ndërmarrjeve të përbashkët si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesës me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.*

2. Për çdo procedurë të njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, do të zbatohen dispozitat e Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**